

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT

**NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR/KONTRATËS GJATË
ZBATIMIT**

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Adresa Rruga “M.Gjollesha”, ish Instituti i Ndertimit (pranë IKMT), Tiranë
Tel/Faks +355 4 234885
E-mail prokurimet@albaniandf.org
Ueb-faqe www.albaniandf.org

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri L.Halimi
E-mail prokurimet@albaniandf.org

3. Lloji i procedurës së prokurimit: “E hapur mbi kufirin e lartë monetar” Marrëveshje Kuadër.

4. Lloji i kontratës /Marreveshjes kuader: Furnizim Mall.

5. Numri i referencës së procedurës /Lotit: Loti 1 REF -39129-08-17-2022

6. Objekti i Marrëveshjes Kuadër: Lotil “Blerje materiale ndërtimi sipas kerkesave te Bashkive”. Objekti i kontratës: Mbështetje me furnizim materiale ndërtimi, për realizimin e punimeve për projektet: "Ndërtim dhe ndriçim trotuare per fshatin Çermë Siper-Çermë Sektor, Bashkia Divjakë; - Ndertim rrjeti kanalizimesh per ujerat e ndotur ne fshatin Melcan dhe Turan", Bashkia Korçë; - Shtrim rruge me beton lagjia Llukan Prifti", "Shtrim rruge me beton rruga Niko Hoxha", "Shtrim rruge me beton rruga Dine Gega", "Shtrim rruge me beton rruga Drizes", "Ndertim KUZ në lagjen Tafil Skendo dhe Ndricim rrugor rruga Naftetari", "Shtrim rruge me beton plus ndricim rrugor rruga Mema, Nj.A. Perondi, Fshati Tapi ", bashkia Kucovë; - "Punime rrethimi, Sistemimi e punime rrugore shkolla 9 vjecare, fshati Nange", "Rrethim dhe sistemim oborri i shkolles 9 vjecare Qinamak", dhe "Mobilim Urban lagjia 1,2,3,7", Bashkia Kukës; - “Rikonstruksion i sheshit nr.1 dhe nr.2 ne rrugen Jakov Xoxa Njesia Administrative 4", "Rikonstruksion sheshi i pallatit tek ish Kinemaja Verore, Lagjia Skender Libohova, Njesia Administrative 3", "Rikonstruksion i sheshit lagjia Xhevdet Nepravishta, Njesia Administrative 2", "Sistemim i sheshit te pallatit ne hyrje dalje ne rrugen Besim Nuri, lagjia Xhevdet Nepravishta, Njesia Administrative 2", Bashkia Lushnje; - "Rehabilitimi I parkut te qytetit te Rrogozhines, Bashkia Rrogozhinë.”

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): - FPP) 44111000-1, 44111000-4

8. Fondi limit marrëveshjes kuadër: 145,832,293.33 leke pa tvsh

9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë: Neni 127 të LPP pika 1/c ku parashikohet; “Kontrata publike apo marrëveshja kuadër mund të modifikohet pa zhvilluar një procedurë të re prokurimi në rastet e mëposhtme: c) kur modifikimi është bërë i nevojshëm për shkak të rrethanave të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor dhe që nuk ndryshojnë në thelb natyrën e kontratës publike apo të marrëveshjes kuadër”.

10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës/Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e punimeve

1.Referuar në pikën 3 të kontratës afati i realizimit është 45 ditë nga nënshkrimi i kontratës, me përfundim datë 21.01.2023.

2.Me shkresë nr. 107 prot., datë 18.01.2023 të kontraktorit “VIBTIS” sh.p.k dhe kërkesës datë 19.01.2023 të Drejtorisë së Menaxhimit të Programeve, është kërkuar shtryje e afatit të kontratës me argumentimin; “disa nga bashkitë kanë deklaruar se nuk janë në gjendje për të kryer procesin e furnizimit me materiale brenda një kohe të shkurtër, si dhe angazhimi i stafit në emergjencat civile të shkaktuar nga moti i keq.”

Bazuar në:

a) Nenin 24 në pikën 24.1 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) parashikohet; “Nëse në çdo kohë gjatë ekzekutimit të Kontratës, Furnizuesi ose nënkontraktorët e tij hasin kushte që pengojnë dërgimin në kohë të Mallrave ose përfundimin e Shërbimeve të Lidhura në përputhje me Nenin 5, Furnizuesi njofton menjëherë Blerësin me shkrim për vonesën, kohëzgjatjen e mundshme dhe shkakun e saj. Sa më shpejt që të jetë e mundur pas marrjes së njoftimit të Furnizuesit, Blerësi vlerëson situatën dhe në bazë të diskrecionit të tij mund të zgjasë kohën e realizimit nga ana e Furnizuesit. Në këtë rast zgjatja miratohet nga Palët dhe reflektohet në modifikimin e Kontratës.”

- b) Në dispozitat ligjore të parashikuara në nenet 659 e vijues të “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”.
- c) Kërkesën për amendim të afatit të kontratës të miratuar nga Drejtoria e Menaxhimit të Programeve modifikohet afati i kontratës shtyhet me 30 dite deri nga nënshkrimi i kontratës datë 07.12.2022 deri më 20.02.2023.

11. Vlera totale e kontratës së nënshkruar/marrëveshjes kuadër: 24,335,770.17 lekë, pa TVSH

12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti): _____

13. Kohëzgjatja e kontratës / Marrëveshjes Kuadër: 45 dite nga nënshkrimi i kontratës Dhe afati i ri (nëse është rasti): Afati i realizimit të kontratës shtyhet 30 ditë, nga nënshkrimi i kontratës datë 07.12.2022 deri më 20.02.2023.

14. Emri dhe adresa e operatorit/ëve Ekonomik:
OE “VIBTIS” sh.p.k NUIS L02103503S, me adresë: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla nr 2, Kati 8/4, Tiranë.

15. Data e nënshkrimit të modifikimit: 19.01.2023

16. Burimi i financimit: Buxheti Shtetit

17. Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti/enti kontraktor: _____